



PAKETA MUSHAMA
PËR DHEUN, BIMËT, KAFSHËT DHE SHËNDETIN E NJERIUT

IDEASS ^{INDI}

Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug - Jug

Hyrje

Teksti i shkruar nga Vedavathy Sanagavarapu dhe Maria Pia Macchi

Paketa Mushama është një kit i prodhuar nga Qendra Kërkimore për Bimët Popullore (QKBP), Tirupati, në Indi, për trajtimin e dheut, bimëve, kafshëve dhe shëndetit të njeriut duke përdorur pjesë të bimës së Neem (*Azadirachta indica* Ajuss). Neem është një pemë e madhe, gjithmonë e gjelbër që rritet deri 10-11 metra e gjatë. Ajo ka lule të vogla të bardha në këndin që krijojnë degët dhe fruta të gjelbra ose të verdha të cilat përmbajnë nga një farë; kjo farë ka përbërje vajore rreth 40%. Ndërsa të gjitha pjesët e pemës kanë veti shëruese.

Indianët kanë shfrytëzuar vetitë mjekësore të Neem prej mijëra vitesh: ajo është një pemë e shenjtë, mjaft e përdorur gjatë ceremonive fetare. Në Vedas, Neem quhej sarvaroganivarini ("ajo që shëron gjithë sëmundjet dhe të këqijat") Gjithashtu edhe mitologjia flet për vetitë kurative të saj, si dhe adhurimin e njerëzve për të parandaluar fatkeqësitë dhe sëmundjet. Fillimet e shkrimeve mjekësore në sanskritisht i referohen vetive të mira të frutave, farërave, vajrave,



gjetheve, rrënjëve dhe lëkurës së Neem që janë përdorur në sistemet mjekësore të Ayurvedic Indian, Siddha dhe Unani për të luftuar problemet e lëkurës, ulçerën e stomakut, pleshtat e pulave, leprozën, verdhëzën, diarrenë, plagët, djegiet dhe sëmundjet të tjera. Gjatë epidemive njerëzit bëjnë banjo me ujë ku më parë janë zier gjethe të Neem për të hequr të keqen. Bima e Neem përdoret gjerësisht nga popullsia vendase për trajtimin e tokës, bimëve, kafshëve dhe njerëzve. Neem është një pemë aq e përhapur dhe e dobishme në zonat tropikale, sa popullsia vendase e quan "farmacia e fshatit".

Mjekësia moderne ka konfirmuar efektet kurative të Neem. Gjethet, lulet, farërat, lëkura dhe vaji përdoren për një sërë qëllimesh dhe, prania e pemës është vlerësuar si e dobishme për tokën dhe ajrin. Përdorimi i Neem në bujqësi mund të shërbejë edhe si alternativë për pesticidet kimike. Trajtimi i metodave dhe dozimi ndryshon në varësi të atij që përdor bimën për një qëllim të caktuar.

Dr. S. Vedavathy ka punuar për vite me grupet e fiseve indiane për të forcuar bazën e njohurive të tyre tradicionale nëpërmjet programeve të ndërgjegjësimit dhe trajnimit në përdorime praktike për njohuri të vendasve. Para një dekade, kur burimet e informacionit dhe studimet mbi traditat inovative ishin më të pakta, ajo vëzhgoi përdorimin inovativ të pemës magjike nga grupet e banorëve vendas. Nga 1994 dhe 1997, me ndihmën financiare të Qendrës Ndërkombëtare të Kërkimeve për Zhvillim të Kanadasë (QNKZHK), ajo dokumentoi traditat mjekësore vendase dhe mençurinë popullore të popullsisë vendase në

distriktin e Chittor të shtetit Andhra Pradesh, Indi duke u fokusuar në rëndësinë e Neem si për bujqësinë, ashtu edhe për shëndetin parësor. Përdorimi inovator dhe i shumëanshëm i bimës së Neem e bënë që të krijonte me të një Raincoat Package (Paketë Mushama-mbrojtese).

Nuk ka asnjë përbërës tjetër, sintetik ose natyral me kaq përdorime të sigurt dhe të shumta siç ka Neem. Ato bazohen në njohuritë tradicionale të fiseve dhe komuniteteve rurale në Indi dhe ia vlen të njihet më gjerë, pasi Neem ka një kosto të ulët, që gjendet me lehtësi dhe me vlerë për shoqërinë.



Krejt një mushama, që mund të përdoret për të mbrojtur çdo gjë nga shiu, Paketa Mushama e krijuar nga QKBP i lejon të gjitha përdorimet e bimës së Neem. Një Paketë Mushama përmban pesë pjesë të pemës së Neem: lëkurën, rrënjët, frutat, lulet dhe gjethet. E gjitha ajo që kërkohet janë mënyrat e gjera dhe inovative për të përhapur përdorimin e pjesëve të veçanta të bimës në kushte të veçanta. Paketa mushama sugjeron përdorimin e farërave të Neem për të luftuar insektet dhe dëmtuesit e tjerë të drithërave në depo, ndërsa materiali që mbetet përdoret si pleh biologjik (komposto) për tokën. Përveç kësaj, ekstraktet e farës, vaji dhe gjethet, përdoren për qetësimin e kuarjeve (scrabiet), prerjet, puçrrat dhe skuqjen në mënyrë tradicionale. Paketa Mushama është përdorur dhe ka dhënë rezultate të shkëlqyera në fshatrat e zonës së Tirupatit për mbrojtjen e bimëve: është mike e ambientit, me kosto të ulët dhe ka shumë përdorime.

Çfarë problemesh zgjidh?

Paketa Mushama përfshin përdorime të ndryshme të pjesëve të Neem. Ajo është e përshtatshme për përdorim në vendet në zhvillim, sepse prodhohet në fshat me kosto të ulët dhe mund të sigurohet lehtësisht nga fermerët. Paketa i përket një tradite holistike që përfshin trajtimin e tokës, njerëzve dhe bimëve; ka një gamë të gjerë përdorimi dhe pa efekte anësore.

Ajo nxit përdorimin e ekstraktit të farave të copëtuara për të luftuar shumë lloje insektesh të dëmshme. Studimet në terren të bëra nga Qendra e Kërkimeve të Bimëve Popullore (QKBP) në ferma, dhanë rezultate të mira gjatë përdorimit të Neem për të luftuar dëmtuesit kryesorë që sulmojnë lakrën (krimbat), patëllxhanin (krimbat, karkalecat), specin e kuq (krimbat), Ambretta (krimbat, brumbujt) dhe dëmtuesit kryesorë të

Leguminosae dhe Cucurbitaceae. Përdorimi i Paketës Mushama ndalon rigjenerimin e mëtejshëm të dëmtuesve dhe pengon zhvillimin e larvave dhe mbirjen e sporeve të kërpudhave.

Neem nuk është i rrezikshëm për ambientin siç janë pesticidet sintetike: parandalon dëmtuesit pa i vrarë ato. Në të njëjtën kohë është një burim ushqimi të dobishëm për bletët dhe për zogjtë. Gjithashtu rrit praninë e krimbave të dheut në tokë.

Pema e Neem thith grimcat toksike nga ajri, dhe hija e saj parandalon zhvillimin e shumë sëmundjeve. Në zonat ku rritet pema e Neem ka më pak malarje dhe ethe të etiologjive të ndryshme. Ka të dhëna që të bëjnë të mendosh që Neem ndihmon të kontrollojë ndotjen e ambientit.

Gjethet e thata të Neem, gjatë djegies lëshojnë tym që largon insektet. Ky është një zbatim që përdoret veçanërisht në stinët e lagështa me shira, kur demat dhe kafshët e tjera bien pre e mizave.

Paketa Mushama gjithashtu përfshin metoda për ruajtjen e drithërave. Mbeturinat e ekstrakteve të Neem përdoren për të kontrolluar insektet e dheut, sidomos nematodet dhe, si pleh bio për të përmirësuar strukturën e tokës dhe për të pasuruar bazën ushqyese të bimëve.

Më në fund Neem, është gjithashtu i nevojshëm në kurimin e sëmundjeve të kafshëve dhe njeriut. Paketa Mushama tregon përdorimin e tij në shumë mënyra të cilat janë lehtësisht të adoptueshme nga fermerët.





PËRBËRËS TË RËNDËSISHËM FITOKIMIK NË NEEM:

Pema e Neem ka përbërës të shumtë unik që janë identifikuar, dhe të tjerë që nuk janë identifikuar akoma. Përbërësit e identifikuar përfshijnë:

- Nimbin — kundër skuqjes, temperaturës, pickimit të insekteve dhe kundër mykut
- Nimbidin — kundër bakterieve, ulçerës, aritmisë, mykut
- Nimbidal — kundër tuberkulozit, kundëprotozoarëve, kundër temperaturës
- Gedunin — zgjeron enët e gjakut; kundër malaries; mykut
- Sodium nimbinat- diuretik, spermicid, kundër artritit
- Quercetin - kundërprotozoarëve
- Salanin - vret insektet
- Azadirachtin - kundër insekteve

Neem ka një shije të hidhur e cila lidhet me praninë e përbërësve të quajtur "triterpene" ose "limonoide". Afërsisht 100 përbërës protolimonoide, limonoide ose tetranortriterpenoide dhe disa nonterpinoide janë izoluar nga pjesë të ndryshme të pemës (Jones et al., 1989; Koul et al, 1990) dhe pjesë të tjera vazhdojnë të vëzhgohen e të veçohen. Principi më i rëndësishëm bioaktiv është azadirachtin; së paku dhjetë limonoide kanë veçori që të pengojnë rritjen e insekteve.(Saxena, 1989, Schmutterer, 1990).

PËRBËRJA FIZIKE E GJTHEVE TË FRESKËTA TË NEEM

Ujë	59.4%
Proteina	7.1%
Yndyrë	1.0%
Fibra	6.2%
Karbohidrate	22.9%
Minerale	3.4%
Kalori	1290 Kkal/kg

VLERAT PËR 100g:

Kalcium	510 Mg
Fosfor	800 Mg
Hekur	17 Mg
Tiaminë	0.04 Mg
Niacinë	1.40 Mg
Vit C	218 Mg
Karotene	1998 Mg
Acid Glutamik	73.30 Mg
Tiroksinë	31.50 Mg
Acid Aspartik	15.50 Mg
Alaninë	6.40 Mg
Prolinë	4.00 Mg
Glutaminë	1.00 Mg

Burimi: Fondacioni Neem, 1997

Paketa Mushama në praktikë

KONTROLLI NDAJ DËMTUESVE

Përdorimi i kimikateve të agrikulturës në vendet e zhvilluara shpesh ka pasur efekte negative, duke përfshirë helmimin dhe degradimin e ambientit.

Kërkimet e fundit kanë treguar se Neem është shumë efikas për mbajtjen nën kontroll të dëmtuesve. Gjethet, frutat, dhe farat e Neem janë përdorur në mënyrë efektive si një frenues për shumë dëmtues. Ndryshe nga kimikatet artificiale, të cilat mbysin insektet që mund të jenë të dobishme për të ngrënë dëmtuesit e të mbjellave, ekstrakti i Neem zakonisht nuk i mbyt insektet e dëmshme menjëherë, por ai ndryshon të ushqyerit ose ciklin jetësor të insektit, derisa ai nuk është më në gjendje të mbijetojë e të riprodhohet. Kjo do të thotë se

ekstrakti i Neem kërkon kohë të veprojë në rastin kur dëmtuesit janë të fuqishëm, dhe vepron në mënyrë të përsosur si një trajtim parandalues për dheun dhe bimët. Insektet e dëmshëm u shmangen bimëve të trajtuara me ekstraktin e Neem, i cili vepron si një ekran ose mburojë. Asnjë mbetje e dëmshme nuk mbetet në tokë ose ambient.

Përgatitja e mushamasë është shumë e thjeshtë dhe me kosto të ulët, e përballeshme për fermerët me pak të ardhura. Për përgatitjen e saj nevoiten pajisje të zakonshme bujqësore si pompa, mikser, mulli, havan dhe shtypës. Shtypësja për nxjerrjen e vajit është shumë e kushtueshme, por shitja e vajit është një burim i mirë fitimi. Dy pemë dhjetëvjeçare sigurojnë pesticide të mjaftueshme për një kopsht bimor me madhësinë e një kuzhine normale



RUAJTJA E DRITHËRAVE

Ruajtja e drithërave është një metodë vendase e zhvilluar nga qendra për përdorimin e pjesëve të bimës së Neem. Nga përzierja e drithërave me gjethet e thara mirë, dëmtuesit qëndrojnë larg drithërave për një vit të tërë. Gjithashtu mund të mësohen dhe zbatohen praktika më të sofistikuar, por në çdo rast metodologjia është e thjeshtë dhe nuk kërkon makineri. Një bimë pesëvjeçare është më se e mjaftueshme për të siguruar ruajtjen e drithërave për një familje.

LARGON MUSHKONJAT, ËSHTË PLEH DHE USHQIM PËR KAFSHËT.

Bari kundër mushkonjave, plehu dhe ushqimi i kafshëve mund të prodhohen nga mbetjet nga nxjerrja e vajit. Shkopat për ndezje, miq të mjedisit, që largojnë mizat dhe mushkonjat prodhohen lehtësisht; njerëzit e zakonshëm dhe fermerët mund t'i përgatitin ata pa ndonjë makineri të kushtueshme. Pas nxjerrjes së vajit mbetet një pleh dhe ushqim i shkëlqyer për kafshët pa asnjë shpenzim shtesë.

KUJDESI SHËNDETËSOR PARËSOR

Paketa Pardesy mund të përdoret gjithashtu për kujdesin shëndetësor parësor. Ekstrakti i Neem është i dobishëm për trajtimin e çrregullimeve të lëkurës, puçrrave, skuqjes, kruarjeve, ulçerës e plagëve. Gjethet e Neem gjithashtu ndihmojnë në trajtimin e çrregullimeve vatike (dhimbje neuromuskulare). Ato largojnë helmet, pastrojnë gjakun dhe neutralizojnë fuqimisht radikalet e lira të dëmshme në trup, si dhe ndihmojnë në kurimin e syve dhe kundër pickimit të insekteve. Frutat e Neem, të cilat janë të hidhura, kanë veti purgative, kundër hemorroideve dhe kundër parazitëve në natyrë. Lulet e Neem janë shtërnguese, sigurisht johelmuese, dhe përdoren për trajtimin e situatave dhe sëmundjeve të shoqëruara me temperaturë të lartë dhe kollë.

Farat e Neem, të cilat janë edhe të hidhura në shije, shërbejnë kundër parazitëve, kundër leprozës dhe mund të përdoren si një kundërhelm (antidodë) për helmimet. Vaji i përftuar nga shtrydhja e farës është një antidermatonic dhe një anthelmintic (kundër parazitëve) i fuqishëm. Ai ka një spektër të gjerë veprimi dhe ka vlera të larta mjekësore.

Pesë pjesët e pemës së Neem të përfshira në Paketën Mushama janë të gjitha të dobishme për çdo gjendje të dobësisë së organizmit, për sëmundjet e lëkurës, kruarjet, plagët, djegiet, temperaturën e lartë dhe qëllime të tjera të përmendura më parë.

QËLLIME TERAPEUTIKE

Frutet e Neem, farat, vaji, gjethet, lëvorja dhe rrënjët gjejnë përdorim si antiseptikë e antibakterialë të përgjithshëm, në trajtimin e çregullimeve urinare, të diarresë, etheve, sëmundjeve të lëkurës, djegieve të infektuara, hipertensionit dhe sëmundjeve inflamatore. Vaji i Neem dhe përbërësit e tij — nimbidin, nimbidiol dhe nimbin, pengojnë zhvillimin e mykut tek njerëzit dhe kafshët. Ekstraktet dhe çajrat e gjethëve të Neem përdoren për kurimin e malarjes; Veprimi anti-malarial i atribuohet përbërësit gedunin, një limonoid i pranishëm në gjethë. Azadirachtin, ose Ekstrakti i Neem mbron nga pickimi i tartabiqeve dhe parazitëve protozoarë.



Ilaçet popullore të përgatitura me Neem në kushte shtëpie janë të thjeshta, por të efektshme. Nuk nevojitet asnjë makineri, por është e rëndësishme të njihet mënyra e duhur e përgatitjes së tyre si dhe dozat e sakta. Cilësia e materialit të përpunuar është gjithashtu e rëndësishme, sepse farat bëhen helmuese në qoftë se nuk mbliidhen dhe thahen siç duhet. Nga përgatitja e ose përdorimi i pasaktë, ilaçet e përgatitura në shtëpi mund të jenë madje edhe helmuese.

Një bimë Neem pesëvjeçare është e mjaftueshme për plotësimin e nevojës për ilaçe të një familjeje.

VAJI I NEEM

Vaji i Neem është produkti më i rëndësishëm nga pikëpamja tregtare që nxirret nga bima e Neem. Ai është një përbërës i rëndësishëm i preparateve farmaceutike dhe kozmetike jo vetëm në Indi, por edhe në Europë e Shtetet e Bashkuara. Kërkesat e tregut janë në rritje dhe shkalla e shitjes është e lartë.

Në vitin 1990, India importoi rreth 3 ton vaj Neem me vlerë rreth 7500 euro, por me mbledhjen dhe përdorimin e përmirësuar, India mund të

prodhojë rreth 700 000 ton për eksport. Në shumë zona të Indisë vaji është një burim i mirë të ardhurash për bashkësitë rurale. Në qytetin e Pune-s, Komisioni i Industrive "Kadhi and Village" hapi një treg të mirë për vajin Neem mbi një bazë racionale dhe të organizuar. Në shtetin Tamil Nadu, Federata e Grave të Mahakalasant dhe CCD kanë tregtuar vajin Neem me rezultate të mira. Në Kannyakumari, NARDEP ndihmon Grupin Lokal të Ndihmës Vetjake të Gruas në prodhimin dhe tregtimin e vajit Neem.

Prodhimi i vajit përfshin thyerjen e farëve dhe veçimin e thelbit për t'u shtypur. Vaji i prodhuar, nganjëherë peshon sa 50% e peshës së thelpinjve. Vaji përbëhet nga trigliceride dhe nga acidi: oleic (41%), stearic (20%), linoleic (1%) e palmitic (18%). Çdo pemë Neem jep 5 – 6 kg vaj Neem në vit.

Mbeturinat nga nxjerrja e vajit mund të përdoren me sukses në bujqësinë organike. Ato përmbajnë më shumë nitrogjen, fosfor, potas, kalcium dhe magnez, sesa plehu i bagetive dhe është gjerësisht i përhapur në Indi si pleh dhe si pesticid që mbron rrënjët e bimëve nga milingonat e bardha dhe nematodet.

Rezultatet

India ka rreth 25 milion pemë Neem dhe prodhon 0.5 milion ton fara të Neem çdo vit. Çdo pemë prodhon 5-6 kg vaj Neem në vit, duke siguruar një minimum të ardhurash prej dhjetë eurosh për pemë vetëm nga vaji. Ngaqë është aq e përhapur në Indi, pema e Neem mund të përdoret me kosto shumë të ulët ose falas.

VLERAT BAZË TË PAKETËS MUSHAMA

- Për përmirësimin e tokës
- Si ushqim për tokën
- Për ruajtjen e drithërave
- Kundër dëmtuesve
- Për kujdesin ndaj lëkurës dhe mishit të dhëmbëve

Paketa Mushama e zhvilluar nga HFRC shërben për qëllime të shumta dhe është mike e mjedisit. Ajo luan një rol kyç në garantimin e një ushqimi të sigurt, duke përmirësuar shëndetin e njeriut dhe duke ruajtur mirëqenien e qenieve njerëzore në mënyrë afatgjatë. Në të ardhmen bota duhet të shqyrtojë mënyrat dhe proceset natyrale për menaxhimin e dëmtuesve dhe vlerave ushqimore, shëndetin e njeriut dhe ruajtjen e mjedisit. Paketa Mushama e siguron një gjë të tillë. Paketa ka qenë tashmë një mjet mbështetës për komunitetet, duke u kursyer atyre shpenzimet si në bujqësi, ashtu edhe në kujdesin ndaj shëndetit parësor.

HFRC ka filluar në një shkallë të vogël prodhimin e këtyre produkteve, që si përbërës kryesor kanë Neem:

- Vaji kundër parazitëve të kokës
- Vaji kundër zbokthit
- Krem për lëkurën e plasaritur të këmbëve
- Pudër për dhëmbët
- Barna bimore kundër etheve
- Pomadë bimore për infeksionet e lëkurës.

Të gjitha produktet janë testuar dhe tregtuar në Andra Pradesh nga Suveda Herbals. Të ardhurat nga shitjet ndihmojnë për të mbajtur një klinikë falas të drejtuar nga HFRC-ja në të njëjtën zonë fisnore ku Dr. Vedavathy bëri kërkimin e saj në terren, ndërsa produktet shpërndahen falas në dy farmaci alopatike në zonën e Tirupatit dhe në një klinikë homeopatike në Nellore. Kështu, përfitimet e ardhura nga dijet e komunitetit, janë kanalizuar përsëri në shërbim të komuniteteve. Një hap tjetër është organizimi i aktiviteteve që prodhojnë të ardhura të mëtejshme përmes tregtimit të produkteve të Neem.

Pajisja e thjeshtë laboratorike kushton 500 euro dhe është e mjaftueshme për përpunimin e vajrave, pudrave dhe kremrave. Kërkesa e tregut lokal në Indi është e mirë dhe të ardhurat e siguruar për bashkësitë mund të jenë të larta, veçanërisht sepse të ardhurat nga barnat mjekësore dhe produktet kozmetike mund të jenë 50 herë më të larta sesa ato të arritura nga shitja e vajit të thjeshtë të Neem.

Stafi i HFRC mund të sigurojë lehtësisht trajnim teknik për personat e OJQ-ve, të interesuar në krijimin e një laboratorit dhe një njësie përpunimi Neem. Pasi bëhet një vëzhgim paraprak për të identifikuar nevojat dhe kushtet e veçanta të zonës në të cilën do të zbatohen njohuritë, trajnimi vetë zgjat një javë.



Interesi ndërkombëtar

Ishte viti 1962, kur Pradhan et al. raportoi efektin frenues të thelbit të farës së Neem ndaj karkalecit të shkretëtirës *Schistocerca* që jeton në koloni. Kjo shënoi fillimin e kërkimeve ndërkombëtare rreth vetive të Neem, të cilat vazhdojnë edhe sot.

Tri konferenca ndërkombëtare të mbajtura në Gjermani në vitet 1980, 1983, dhe 1986 nxitën më tej interesin ndërkombëtar për pemën e Neem. Në vitin 1983 Instituti Ndërkombëtar i Kërkimeve Agrikulturale (IARI) në New Delhi organizoi një seminar kombëtar mbi ndikimin e Neem në agrikulturë, që përfundoi me krijimin e një publikimi të veçantë dhe, në vitin 1984 publikoi

Gazetën e Neem. Këshilli Kombëtar i Kërkimeve (i Shteteve të Bashkuara) publikoi të dhëna të zgjeruara rreth Neem në librin e vitit 1992 me titull: *Neem – një pemë për zgjidhjen e problemeve globale*.

Në vitin 1993 në Indi u mbajt Konferenca Botërore mbi Neem. Në Australi u organizua një konferencë tjetër ndërkombëtare në vitin 1996. Afërsisht në të njëjtin kohë, Shoqata e Azisë Jugore për Bashkëpunim Rajonal (SAARC), Qendra Lindje- Perëndim në Honolulu dhe Instituti Ndërkombëtar i Kërkimeve mbi Orizin në Manila organizuan takime të shumta për të zbuluar veprimin kimik të Neem në luftimin e dëmtuesve.



Në një raport të titulluar *Neem – Një pemë që zgjidh problemet globale*, të Këshillit të Kërkimeve Kombëtare me bazë në Washington thuhet: “Ndoshta asnjë bimë tjetër nuk prodhon produkte aq të çuditshme dhe të shumëllojshme as nuk ka aq shumë bioprodukte të shfrytëzueshme sa Neem? Kjo pemë në shekullin e 21-të mund të shënojë një epokë të re në kontrollin ndaj dëmtuesve, të sigurojë miliona barna me çmim të ulët, të pakësojë shkallën e rritjes së popullsisë dhe ndoshta madje të reduktojë erozionin (gërryerjen), shpyllëzimin dhe temperaturat shumë të larta nga një glob i tejnxehur.”

Indianët ndjehen aq të sigurt rreth rëndësisë së kësaj bime, saqë ata e kanë prezantuar atë edhe në vende të tjera, në Afrikë (në brezin tropikal nga Somalia deri në Mauritani) dhe në disa Ishuj të Paqësoris Jugor. Në Malajzi dhe në Filipine ka plantacione të shumta me këtë bimë. Rreth 50 000 pemë janë mbjellë në Meka për t’u siguruar hije pelegrinëve.



Ka projekte për kultivimin e Neem të sponsorizuara nga UNIDO, UNEP, GTZ dhe Fondacioni Fredrich-Nauman, duke njohur rëndësinë e dobisë së saj në nivelin ekologjik dhe në atë ekonomik. CARE, USAID dhe AFGRO janë duke krijuar programe për kultivimin e Neem në Azinë Jugore, Afrikë dhe në Amerikën Qendrore dhe Jugore. Ka plantacione të shumta me Neem në Nikaragua, Honduras, Kuba dhe në Republikën Domenikane.

Në vitin 1992 kooperativa El Buchal në Dahajuro të Venezuelës, filloi një projekt për kultivimin e 11 000 pemëve Neem duke siguruar si rezultat fruta dhe farë. Projekti po përfshin tashmë edhe qytetarët, të cilët po mbjellin pemë të Neem-it në shkolla, kopshte dhe rrugë.

Drejtori i Klinikës Bimore të Wamirithu, në Kenia, filloi përdorimin e Neem për kurimin e ulçerës (80% e rasteve të kuruara), të artritit (i kuruar për një javë), pneumonisë (e kuruar për 3 javë), të sëmundjeve të krahavorit (të kuruara për 3 ditë) dhe të malarjes (të kuruara për një javë), të gjitha me rezultate të shkëlqyera. Në Gambia domatet piqeshin disa javë më parë dhe kishin degë më të shumta e më të mëdha kur plehëroheshin me gjethet e Neem. Për vlerat e tij të mëdha si dru zjarri, plantacionet me Neem janë më të rëndësishmet ndër të gjitha varietetet që mbillen në Nigerinë Veriore. Qymyri i prodhuar nga druri i Neem është i një cilësie të shkëlqyer.

Në shumë vende të Azisë mjalti i Neem sjell një përfitim të madh dhe anëtarët e OJQ-ve po nxisin apikulturën përmes mbjelljes së pemëve të Neem. Gjethet e Neem janë përdorur së tepërmi në fushat e mbjella me duhan në krahinën Jaffa në Sri Lanka. Në Nepal BIRD po nxit kulivimin e Neem në Terai sipas një programi zhvillimi të një bujqësie organike në të ardhmen. BIRD është gjithashtu i interesuar në veprimtaritë që sjellin të ardhura lidhur me produktet e Neem. Në Bangladesh COE (një OJQ italiane) po e përfshin ndër bimët më të

rëndësishme që sjellin të ardhura dhe që stimulojnë shëndetin, për t'u kultivuar dhe përdorur nga komunitetet më të varfëra, si pjesë e një projekti të themeluar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Italisë në bashkëpunim me OJQ-në DALIT. COE po kryen kërkime në terren mbi bimën e Neem, që në Indi drejtohen nga Dr. Maria Pia Macchi si pjesë e një projekti të filluar në vitin 2002 nga Ministria e Punëve të Jashtme e Italisë për vlerësimin e traditave shëndetësore vendase në Azi, Afrikë dhe Amerikën e Jugut.

Përdorimi i Paketës Mushama në vendet e tjera



Pema e Neem mund të kultivohet në rajone të thata, gjysmë-të thata, tropikale dhe gjysmë-tropikale. Rrënja është në gjendje të thithë lëndët ushqyese dhe lagështirën edhe nga tokat ranore. Kjo specie ka një aftësi të gjerë përshtatjeje dhe është shumë tolerante ndaj dherave të ndryshme dhe kushteve klimatike. Ajo nuk kërkon as ujë, plehërim apo ndonjë kujdes tjetër të veçantë.

Pema e Neem rrit pjellorinë dhe aftësinë ujë-mbajtëse të dheut, sepse ajo ka një cilësi unike të shfrytëzimit të kalciumit që neutralizon dherat acide. Pema është shfrytëzuar me sukses për rryllëzimin e zonave të thata dhe luginave të zhveshura, duke kontrolluar erozionin (gërryerjen) e dheut dhe si erëpritisë.

KUSHTET PËR KULTIVIM

Ph i dheut (treguesi i aciditetit) i nevojshëm për një rritje optimale është 6.2 e sipër, por pema mund të rritet gjithashtu edhe në dheun acid me Ph rreth 5 dhe në atë bazik me Ph 8.5. Në fakt, plehu i gjetheve mund të ndihmojë në vendosjen e kushteve normale mbi sipërfaqen e tokës. Pema nuk mund të tolerojë dherat e kripura, dherat e tejlagura sezonale dhe rërën tepër të thatë (me ujë nën 18 m).

Neem rritet përgjithësisht në një lartësi mes 1 000 dhe 1 500 m. Pema mund të përballojë temperaturat e hijes deri në 49°C dhe nuk mund të përballojë ngricat. Reshjet nga 450 deri në 1 150-mm janë ideale për Neem, por ajo mund të durojë gjithashtu edhe një stinë të thatë të gjatë (130-mm reshje shiu vjetore).

SHUMËZIMI VEGJETATIV

Prerja e Filizit dhe rrënjëzimi (për shumëzim) në ajër është shumë shumë i thjeshtë. Pema gjithashtu mund të shumëzohet lehtësisht përmes prerjes së rrënjës.

SHTIMI I FARËS

Farat shpërndahen zakonisht nga zogjtë në kushte natyrore. Farat bien në tokë gjatë stinës me lagështirë dhe duhet të mblidhen dhe përdoren brenda dy javëve. Farat gjithashtu mund të mblidhen direkt nga pema, kur janë të pjekura dhe të mbillen sa më parë të jetë e mundur. Rezultatet janë shumë të mira, për sa kohë që farat nuk lihen të qëndrojnë për një kohë të gjatë sa të përfundojë krejt procesi i mbledhjes së tyre.

TEKNIKAT E FIDANISHTES

Plehu organik i kopshteve të fermës, rëra dhe dheu duhen përzier në raportin 1:1:3. Mbjellja në

parcelat e fidanishtes duhet bërë në rreshta 15 cm larg njëri-tjetrit dhe largësia ndërmjet farave (në rresht) duhet të jetë 2.5cm. Ata duhen mbuluar pak me dhë, ngaqë farat kur mbijnë në sipërfaqe janë pre e zogjeve dhe insekteve. Parcelat duhen ujitur lehtë dhe dheu duhet mbajtur i shkrifëruar për të parandaluar ngurtësimin.

Rasatet mund të mbillen kur janë rreth dy muajshe. Ata nuk kërkojnë hije. Farat duhet të mbijnë pas një jave.

Rasatet e fidanishtes mund të mbillen kur arrijnë 7 deri 10 cm lartësi. Është mirë të krasiten rrënja dhe kërcelli. Mbjellja duhet bërë gjatë stinëve me lagështirë. Mbjellja e tyre nën shkurret gjëmbore mund të sigurojë një mbrojtje efektive nga dëmtimi i kafshëve.



Mbështetja e Qendrës së Kërkimeve të Bimëve Popullore (QKBP)

QKBP mbështet trajnimin për përcimin e teknologjisë dhe aftësi të menaxhimit bashkësive, fermerëve dhe partnerëve për zgjerimin e njohurive të tyre, si dhe zhvillimin e iniciativës dhe monitorimin e komuniteteve në qoftë se është nevoja. Qendra ndihmon për kultivimin e Neem dhe u shpërndan informacion komuniteteve lokale lidhur me përgatitjen dhe përdorimin e produkteve duke përdorur burimet lokale. Qendra synon të arrijë vetëbesimin e fermerëve përmes një metode gjithëpjesëmarrëse.

Trajnimi mbështet fermerët në arritjen e vetëbesimit për plotësimin e nevojave me insekticide/ pesticideve përmes grupeve të ndihmës vetjake (GNV). Fushatat e ndërgjegjësimit kanë rezultuar në përdorimin e ekstraktit të thelbit të Neem dhe vajit për kontrollin ndaj dëmtuesve në shumë fshatra. Grumbullimi intensiv i farëve të Neem që u pasua nga mbjellja në një shkallë të gjerë e Neem në fushat, tokat e komunitetit, në zonat ujëndarëse si dhe në tokat e lëna të pashfrytëzuara. Përdorimi i Neem si një insekticid dhe pesticid dhe zëvendësimi i produkteve kimike ka qenë i vëzhguar dhe fshatarët kanë ndarë eksperiencën mes njëri-tjetrit. Përdorimi i produkteve të bazuara në Neem ka pakësuar numrin e insekteve të dëmshme të dheut, mykun dhe prazitët, kurse mbetjet e Neem siguruan pasurimin e lëndëve ushqyese.

Ruajtja e drithërave duke përdorur Neem ka përmirësuar shëndetin dhe ka ulur shpenzimet. Kujdesi për mishin e dhëmbëve dhe lëkurën është bërë realitet në ato vende ku Neem është e pranishme dhe përdoret.

Kurs trajnimi mbi përdorimin e bimës së NEEM për kujdesin ndaj shëndetit parësor të njerëzve dhe të kafshëve: 20 pjesëmarrës për 6 ditë

Kursi përmban: Hyrjen, Karakteristikat taksominale dhe rëndësinë mjekësore, kultivimin, etj, si edhe përgatitjen e ilaçeve në kushte shtëpie me bazë bimën e Neem.

Grafiku: Gjatë katër ditëve të para grupi mëson si përgatiten pudrat bimore, ekstraktet, çajrat, pastat, vajrat, pudrat për banjot, tabletat dhe kapsulat për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm për lëkurën (të gjithë problemet e lëkurës, mykotike, bakteriale, virale dhe infeksionet duke përfshirë alergjitë) dhe ethet (virale dhe bakteriale). Ditën e pestë pjesëmarrësit në trajnim mësojnë si përgatiten ilaçet mjekësore (leham dhe ekstraktet) për çregullimet urinare. Ditën e gjashtë grupi mëson si përgatiten vajrat, kremrat, pastat, pasta e dhëmbëve, locioni për trupin dhe duart, për: inflamacione (mahisje), thyerje kockash, djegie nga dielli, për flokët (parazitët e kokës) dhe kujdesin ndaj dhëmbëve.

Kurs trajnimi mbi teknologjitë bujqesore 'MIKE' të mjedisit: 20 pjesëmarrës për 10 ditë

Grafiku: Një orë hyrëse përfshin përbërësit kimikë dhe veprimin e Neem dhe natyrën e dëmtuesve, me një demonstrim praktik mbi mënyrën e përdorimit të pesticideve bio dhe plehut bio tek bimët. Gjatë 5 ditëve pjesëmarrësit mësojnë si përgatiten pesticidet bio duke përdorur gjethet dhe farat e Neem. Në 5 ditët që pasojnë ata mësojnë si ta përdorin Neem për ruajtjen e grurit dhe ushqyerjen e kafshëve dhe si të përgatisin plehun bio (torta Neem).

Për më shumë informacion

BIBLIOGRAFIA

- Ahmed, S., Bamofleb, S & Munshi, M. 1989. Kultivimi i Neem (Azadirachta indica) në Arabinë Saudite. *Ekonomi Botanike*, 43 (1): 35-38.
- Aiyadurai, S.G. 1959. Një shënim mbi mbirjen e farëve të Neem (Azadirachta indica A. Juss). *Gazeta e Agrikulturës së Madras*, 46: 127-140.
- Anonymous. 1992 Pema e Neem mund të jetë burim i insekticideve të sigurta. *Korrespondenti i IRRI* 82 (2).
- Chaurasia, S.C. & Jain, P.C. 1978. Aktiviteti bakterial i vajrave esenciale të katër bimëve mjekësore. *Indian J. Hosp. Pharm.* 15 (6): 166-168
- Conrich, J. 2001 *Neem: Bima themelore*. Varanasi, Pilgrims Publ.
- Këshilli i Kërkimeve Shkencore dhe Industriale (CSIR). 1948-1976. *Begatia e Indisë* (11 vol.). New Delhi.
- Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Agrikulturën (FAO). 1988. *Bimët ushqimore tropikale*. Gazeta N. 42. Rome.
- FAO. 1991. *Burimet gjenetike të pyllit*. Rome.
- GTZ. 1980. *Pesticidet natyrale nga pema e Neem (Azadirachta Indica A Juss.) dhe bimë të tjera tropikale*. Proc. Konferenca e Parë Ndërkombëtare mbi Neem. Rottah-Egern, Gjermania Perëndimore, 16-18 Qershor. (Schmutterer, H., Ascher, K.R.S. & Rembold, H., eds.)
- GTZ. 1984. *Pesticidet natyrale nga bima e Neem (Azadirachta indica A. Juss) dhe bimë të tjera tropikale*. Proc. Konferenca e dytë ndërkombëtare Mbi Neem. Rauishholzhausen, Gjermania Perëndimore, 25-28 Maj, 1983. (Schmutterer, H. & Ascher, K.R.S., eds.)
- GTZ. 1987. *Pesticidet natyrale nga Bima e Neem (Azadirachta indica A. Juss) dhe bimë të tjera tropikale*, Proc. Konferenca e tretë ndërkombëtare mbi Neem. Naerobi, Kenia, 10-15 Korrik 1986. (Schmutterer, H. & Ascher, K.R.S., eds.)
- Hedge, N.G. 1992 *Neem: Silvikultura dhe prodhimi*. *Gazeta Neem*, 9: 1-4.
- IARI. 1983. *Neem në agrikulturë*. Res. Bull. No 40. New Delhi, Instituti Indian i Kërkimeve Agrikulturale.
- IARI. 1993. *Neem në Agrikulturë*. Res. Bull. No 40. New Delhi, Instituti Indian i Kërkimeve Agrikulturale. (Parmar, B.S. & Singh, R.P., eds.)
- Jacobson, M. (ed.). 1988. *Fokus mbi vetitë fotokimike të pesticideve*, Volumi 1. Pema e Neem. Boca Raton, Florida, Shtetet e Bashkuara, CRC Press, Inc.
- Norten, E. 1999. *Neem: Bima shëruese magjike e Indisë*. Vermont, Healing Art Press.
- Pradhan, S., Jotwani, M.G. & Rai, B.K: 1962. *Fara e Neem frenuese e karkalecit*.
- Randhawa, N.S. & Parmar, B.S. (eds.). 1993. *Kërkimi dhe zhvillimi i Neem*. SPS Botimi No.3. Indi, Shkenca e Shoqërisë së Pesticideve.
- Saxena, R.C. 1989. *Insektidet nga pema e Neem*. In J.T. Arnason, Philogene, B.J.R. & Morand, P., eds. *Insektidet e bimës së origjinës*, pp. 110-135 ACS Seritë e Simpoziumit No. 296, Washington, D.C., Shoqëria Kimike Amerikane.
- Singh, R.P. & Kataria, P.K.. 1991. *Insektet, parazitët dhe myku të trajtuar me Neem (Azadirachta) indica A. Juss) në Indi*. *Gazeta Neem* 8 (1): 3-10.
- Tewari, D.N. 1992. *Monograph mbi Neem (Azadirachta indica A. Juss)*. Dehradun, Indi, Shpërndarësit ndërkombëtarë të librit.
- Vijayalakshmi, K., Radha, K.S. & Shiva, V. 1995. *Neem: Një manual i përdoruesit*. Chennai, India, Qendra për Sistemet e Njohurive Indiane.



Kë të kontaktojmë?

Për më tepër informacion dhe për t'u trajnuar mbi Paketën Mushama që ka shumë përdorime mund të kontaktoni:

Dr. Vedavathy, Presidente e Qendrës Kërkimore të Bimëve Popullore.
B-23, Vaikuntapuram
Tirupati 517502
Indi
Telefon: (91) 0877-2242605
(91) 0877-2258860
Cel: (91) 9849046120
E-mail: vedavathy@hotmail.com

Dr. Maria Pia Macchi, pika kryesore e COE për Indinë; Presidente e Magia Verde onlus.

Shiva Pnya Ashram,
P.B. 29, Shencottai
Tamil Nadu 627809
Indi
Telefoni në Indi: (91) 4633-227183
E-mail: magiaverdeonlus@yahoo.it

Iniciativa IDEASS – Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug – Jug është promovuar nga programet e mëposhtme për bashkëpunim ndërkombëtar: ILO/Universitas, UNDP/APPI, dhe UNDP/ IFAD/UNOPS Programet për Zhvillim Njerëzor dhe Programet Kundër Varfërisë, aktualisht prezente në Shqipëri, Angola, Kolumbi, Kubë, El-Salvador, Guatemalë, Honduras, Mozambik, Nikaragua, Republikën Domenikane, Serbi, Afrikën e Jugut e Tunizi. Iniciativa e bashkëpunimit është rezultat i Samiteve Botërore në vitet 1990 dhe i Asamblesë së Përgjithshme të Mileniumit; ajo i jep përparësi bashkëpunimit mes protagonistëve në Jug, me mbështetjen e vendeve të industrializuara.

Qëllimi i IDEASS është të forcojë efektivitetin e proceseve të zhvillimeve lokale përmes përdorimit në rritje të inovacioneve për zhvillim njerëzor dhe kushte të mira pune. Përmes projekteve të bashkëpunimit jug-jug, ata veprojnë si një katalizator për përhapjen e inovacioneve sociale, ekonomike dhe teknologjike që favorizojnë zhvillimin ekonomik dhe social në nivel lokal. Inovacionet e promovuara mund të jenë produkte, teknologji, ose praktika sociale, ekonomike, ose kulturore. Për më tepër informacion rreth Inicativës IDEASS vizitoni faqen e internetit: www.ideassonline.org

IDEASS

Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug - Jug



Programi i PNUD-it Inicativat e Partneritetit Kundër – Varfërisë (APPI) është një program i projektuar për të ndihmuar qeveritë dhe aktorët socialë për të vendosur dhe zbatuar politika kombëtare për uljen e varfërisë dhe përjashtimit social, bazuar në praktikën dhe zhvillimet të integruar dhe gjithëpjesëmarrës në nivel lokal.



Programet për zhvillim njerëzor dhe kundër varfërisë të zbatuara UNDP, IFAD, ILO, dhe UNOPS përkrahin proceset e zhvillimit lokal të integruar dhe gjithëpjesëmarrës brenda kuadrit të politikave kombëtare, me mbështetjen e aktoreve publike, private, dhe shoqërinë civile. Këto programe sigurojnë kornizën brenda së cilës vendet dhuruese dhe komunitetet në vendet e industrializuara mund të bashkëpunojnë në mënyrë të organizuar, përmes bashkëpunimit të decentralizuar. Brenda këtij kuadri do të realizohen dhe bashkëpunimet jug – jug përmes Inicativës.



Programi ILO/Universitas (punë korrekte përmes trajnimit dhe inovacionit) inkurajon përdorimin e zgjidhjeve inovative të problemeve në zhvillimin njerëzor, veçanërisht në botën e punës. Për të arritur këtë, ai kryen veprimtari kërkimore dhe trajnon vendim-marrësit dhe personelin që punon për zhvillimin lokal.



Në Shqipëri, IDEASS është një iniciativë e programit PASARP (Programi i Aktiviteteve në Mbështetje të Qarqeve dhe Prefekturave Shqiptare), realizuar nga IFAD/UNOPS me fondet e bashkëpunimit italian.